

## **PËRMBLEDHJE PËR WEB “MBI ANALIZËN VJETORE TË DEPARTAMENTIT JURIDIK, KONTROLLIT TË ZBATIMIT TË STANDARDEVE DHE SIGURIMIT TË CILËSISË SË AUDITIMIT DHE ETIKËS, DREJTORISË SË METODOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT DHE DREJTORISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM”**

Më datën 4 Shkurt 2022, në mjediset e KLSH-së u zhvillua analiza vjetore për punën e kryer gjatë vitit 2021 të Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit dhe Etikës, Drejtorisë së Metodologjisë dhe Zhvillimit dhe Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm.

Aktiviteti u hap nga Sekretarja e Përgjithshme, znj. Valbona Gaxha e cila në fjalën e saj përshëndetëse falënderoi përfaqësuesit e Departamentit/Drejtorive përkatëse për punën dhe bashkëpunimin.

Në vijim fjalën e mori Drejtorja e Departamentit Juridik znj. Borianna Nikolla, e cila paraqiti raportin mbi veprimtarinë e Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit dhe Etikës, për veprimtarinë e sektorit juridik dhe sektorin e etikës të ushtruar nga ana e tyre, përgjatë këtij viti, në fokus të së cilës ka qenë, dhënia e asistencës juridike për KLSH-në, përgjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij institucionale si dhe sigurimi i mbikëqyrjes së rregullave të sjelljes, etikës dhe integritetit nga ana e punonjësve të KLSH.

Më tej znj. Nikolla prezantoi përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të Kontrollit të Lartë të Shtetit, në proceset gjyqësore penale, administrative apo civile ku ky i fundit ka qenë në cilësinë e kallëzuesit, palës ndërgjyqëse dhe/ose personit të tretë. Gjatë vitit 2021, KLSH ka depozituar 14 (katërmbëdhjetë) kallëzime penale pranë Prokurorive të Rretheve Gjyqësore dhe SPAK, për 62 persona, nga këto 1 Drejtor i Përgjithshëm, 2 Drejtor Kabineti, 2 Zv/Kryetar Bashkie 17 Drejtor Drejtorie dhe 40 Përgjegjës Sektori dhe Specialist. Gjatë kësaj periudhe KLSH është angazhuar në 127 procese gjyqësore, nga këto 28 procese gjyqësore penale.

Në prezantimin e saj znj. Nikolla u ndal në bashkëpunimin me SPAK dhe Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore në lidhje me ecurinë e procedimeve penale të regjistruara mbi bazën e kallëzimeve penale të depozituara nga KLSH.

Analiza vijoi me prezantimin e veprimtarisë së Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit nga z. Bexhet Zeqiri me detyrë Drejtor i kësaj drejtorie, i cili në referimin e tij u përqendrua në cilësinë e auditimit që është dhe mbetet një nga sfidat e përhershme për KLSH-në, me synim ofrimin e një veprimtarie audituese në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat e kuadrit rregullator përkatës. Gjatë vitit 2021 nga kontrolli i cilësisë “*në të nxehtë*”, Drejtoria e Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit ka shqyrtuar dhe ka dhënë mendime për 130 auditime të evaduara, nga të cilat: 105 auditime përputhshmërie, rregullshmërie dhe të kombinuar, 11 auditime financiare, 11 auditime performance, 3 auditime IT, si dhe për disa auditime në proces evadimi. Në fjalën e tij z. Zeqiri prezantoi sigurimin e cilësisë nëpërmjet kontrollit vjetor në “*të ftohtë*” të realizuar për 30% të dosjeve të auditimit të evaduara në periudhën janar - dhjetor 2021 ose për 44 dosje auditimi të përzgjedhura në mënyrë rastësore.

***Në vijim veprimtaria e Drejtorisë së Metodologjisë dhe Zhvillimit për vitin 2021, u prezantua nga znj. Brunilda Zeneli, Drejtore e Drejtorisë.***



Raportimi u përqendrua në realizimin e objektivave që rrjedhin nga dokumentet strategjike si: Strategjia për Zhvillim Institucional e KLSH 2018-2022; Plan Veprimi i miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 755/1, datë 01.09.2021 “Për zbatimin e rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për vlerësimin e veprimtarisë së KLSH-së për vitin 2020, miratuar në datë 24.06.2021”; Plan Veprimi “Mbi zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Komisionit Europian për Shqipërinë”, të miratuar nga Kryetari i KLSH nr. 1243, datë 12.11.2021, si dhe Korniza e Matjes së Performancës së SAI-eve (PMF). Gjithashtu u prezantua dhe realizimi i objektivave në zbatim të Programit të Zhvillimit të Integruar Profesional të stafit të KLSH-së për vitin 2021.

### **Drejtoria e Auditimit të Brendshëm u prezantua nga z.Arsen Sinamataj Drejtor Drejtorie**

Në analizën vjetore të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm të KLSH-së, në datën 04.02.2022, në raportimin e tij, Drejtori i DAB-së theksoi se Drejtoria që ai drejton luan një rol të rëndësishëm dhe me impakt të veçantë, pasi kontribuon dhe ndihmon KLSH-në për të arritur objektivat, duke përmirësuar efektshmërinë e menaxhimit të riskut, identifikimin e dobësive të sistemit menaxherial, evidentimin e problematikave të ndryshme dhe dhënien e rekomandimeve përkatëse me qëllim përmirësimin e punës. Po kështu auditimi i brendshëm ndihmon institucionin për të arritur objektivat, nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike, duke vlerësuar e përmirësuar efektshmërinë e menaxhimit të riskut si dhe proceset e kontrollit e të qeverisjes. Duke u ndalur në mënyrë më konkrete z.Sinamataj, theksoi se në vitin 2021 u planifikuan 6 (gjashtë) programe auditimi, duke mbajtur parasysh numrin e burimeve njerëzore të DAB-së. Në përgjithësi janë plotësuar objektivat dhe rekomandimet e dhëna, duke patur parasysh edhe situatën e rënduar të pandemisë në vend.

Për vitin 2022 DAB ka planifikuar gjashtë programe auditimi, duke synuar dhe garantuar zhvillimin e veprimtarisë në përputhje me praktikat më të mira profesionale, menaxhimin efektiv të burimeve, realizimin e veprimtarisë të orientuar nga menaxhimi i riskut, përmirësimin e sistemit të programimit dhe metodologjisë, rritjen e nivelit të cilësisë dhe profesionalizimit, rritjen e nivelit të shërbimit dhe standardeve etike, rritje të cilësisë së raportimit duke respektuar standardet dhe mirë menaxhimin e burimeve njerëzore.

***Analiza vjetore, përfundoi me fjalën përmbyllëse të Sekretares së Përgjithshme, znj. Valbona Gaxha.***